

VENDIM
Nr.272, datë 10.5.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.644, DATË 13.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110 KV, NË ZËMBLAK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 129 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe të neneve 4, 5, pika 1, 8 shkronja “c”, 18, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.644, datë 13.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Zhvlerësimin, për interes publik, të pasurive dhe të veprimtarisë së kantierit të prodhimit të materialeve të ndërtimit, pronë e shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, për shkak të funksionimit, brenda kushteve teknike, të nënstacionit 400/110 kV, Zëmbak, Korçë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Shpronësimi dhe zhvlerësimi të bëhen në favor të KESH sh.a.-së, Tiranë.”.

3. Në pikën 3, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Shoqëria “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, pasuria dhe veprimtaria e së cilës zhvlerësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 22 337 074 (njëzet e dy milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë brenda muajit qershor 2006.”.

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Fondet, për realizimin e shpronësimit dhe të procedurës së zhvlerësimit, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për KESH sh.a., Tiranë, zëri “Kosto lokale për shpronësim.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1. Vlera e shpenzimeve procedurale, për realizimin e procedurës së zhvlerësimit, në shumën 188 000 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, të jetë në ngarkim të KESH sh.a.-së si subjekt kërkues i këtij zhvlerësimi.”.

6. Në pikën 7, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Zhvendosja e kantierit të prodhimit të materialeve të ndërtimit, pronë e shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, të fillojë brenda muajit maj 2006 dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2006.”.

7. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, të bëjë çregjistrimin nga regjistrat e pasurive të paluajtshme të pronës “Ndërtesa”, të shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda muajit maj 2006.”.

8. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, KESH sh.a, Tiranë dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E TE DHENAVE, TE PASURISE DHE AKTIVITETIT TE SHOQERISË “GRAND-INERT” SH.P.K KORÇE, E CILA ZHVLERËSOHET, PËR SHKAK TË FUNKSIONIMIT TË “NENSTSACIONIT 400/110 KV ZEMBLAK-KORÇË.”

RRETHI : KORÇË
FSHATI: ZEMBLAK

Lloji i pasurisë që zhvlerësohet: “Kantier Prodhim Material Ndertimi” , prone e shoqerise “GRAND INERT” Sh.p.k KORÇE

Nr.	PERFAQESUESI LIGJOR I SHOQERISE “GRAND INERT”, Sh.p.k KORÇE	AKTIVITETI I SHOQERISE PASURIA E TE CILES ZHVLERËSOHET	PERBERJA DHE LLOJIT PASURISE QE ZHVLERËSOHET	Numrat e Pasurive, qe zhvlerësohen, prone e shoq. “Grand Inert” sh.p.k Korçë, (Kantier, prodhim material ndertimi) Korçë	Zona kadastrale	Vol.	Faqe	Siperfaqe ne m², per çdo pasuri	Vlera Totale e Kompesimit ne leke.	Adresa
1.	SHYQYRI XHENGGO (Administratori)	Kantier Prodhim Material Ndertimi	Tokë Arë	89/41	3903	16	104	80	22.337.074	Zemblak-Korçë
			Truall	249/14	3903	15	225	617,2		
			Truall	249/15	3903	15	226	293.5, nga kjo 21 m² ndërtësë		
			Truall	249/16	3903	15	227	300,9		
			Truall	249/17	3903	15	228	182		
			Ndertesë	249/20	3903	16	105	29		
			Ndertesë	249/21	3903	16	106	143		
			Ndertesë	249/22	3903	16	107	12,6		
			Ndertesë	248/1	3903	16	108	37,5		
									22.337.074	

(njëzetëdmilion e treqindetridhjeteshtatemije e shtatedhjetekater) leke

Sqarime: Shpenzime proceduriale: Publikime 168.000 (njëqindëgjashdhetetemije) lekë.
Shpërblim i anëtarëve të komisionit të posaçëm 20.000 (njëzetëmijë) lekë.

Shënim: Pasuria e tipit “Tokë Truall” dhe Tokë bujqësore”, ngelet në pronësi të shoqërisë “Grand-Inert” sh.p.k Korçë, por pa të drejtë për të ndërtuar mbi të.